

8


ORGANIZIMI I KISHËS SË JEZUSIT

Shumë njerëz nuk interesohen për mënyrën se si është e organizuar kisha. Megjithatë, organizimi është një çështje jetësore. Organizimi i kishës është skeleti i trupit. Në qoftë se skeleti është i shtrembër, i gjithë trupi do të jetë i deformuar.

JEZUSI ËSHTË KREU

Shumica e sekteve fetare kanë krerë dhe seli tokësore, por kisha e Jezusit kishte (dhe ka) vetëm një kokë: vetë Jezusin. Selia e kishës është në qiell, ku Jezusi është. Pali tha se Perëndia “vuri çdo gjë nën këmbët e tij, edhe ia dha për krye përmbi çdo gjë kishës” (Efesianëve 1:22; shiko edhe Kolosianëve 1:18). Jezusi u tha dishepujve të tij: “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë” (Mateu 28:18).

Krerët dhe selitë tokësore të kishës nuk gjenden në Bibël. Nuk gjenden as marrëveshjet e hollësishme organizative të shumicës së sekteve fetare. Në kohën e Dhjatës së Re nuk kishte asnjë organizatë rajonale, kombëtare apo ndërkom-bëtare të lidhur me kishën. Nuk kishte strukturë organizative më të madhe se bashkësia lokale.



Në figurën e mësipërme, çdo ovale poshtë ovalet së madhe (“Jezusi, kreu”) përfaqëson një bashkësi lokale (BL). Në figurë, çdo bashkësi është vizatuar si e veçantë dhe e pavarur nga të

tjerat. Bashkësitë lokale lidheshin me njëra-tjetrën me anë të dashurisë. Ato e ndihmonin njëra-tjetrën (Veprat 11:28–30; Romakëve 15:25, 26), por s’kishte asnjë lidhje organizative midis tyre.


Ky rregullim quhet nganjëherë “autonomi lokale”. “Autonomi” vjen nga një fjalë e përbërë greke që do të thotë “vetë-qeverisje”. Çdo bashkësi lokale e kishës së Zotit është tërësisht vetë-qeverisëse, e nënshtuar vetëm ndaj Jezusit.

Disa mendojnë se ky rregullim i thjeshtë nuk mund të funksionojë në botën e sotme komplekse. Ata këmbëngulin se nevojiten “makineri” kishtarë shtesë për të përmbushur misionin e kishës. Megjithatë, mund të dëshmoj se rregullimi që ka bërë Zoti është i mjaftueshëm. Kam marrë pjesë në një punë misionare në Australi për dhjetë vjet pa “ndihmën” e ndonjë organizate të krijuar nga njerëzit. U ndihmova nga ana financiare prej kishës së Krishtit në Oklahoma (USA). Edhe kisha të tjera ndihmuan për fondet e nevojshme. Nuk qe nevoja për asnjë shoqëri misionare.

BASHKËSIA LOKALE

Në Dhjatën e Re bashkësia lokale është e vetmja njësi organizative e kishës. Në pjesën tjetër të këtij mësimi, do të përqëndrohemi në organizimin e bashkësive lokale gjatë shekullit të parë. Kur Pali i shkroi një kishë¹ tërësisht të organizuar në Filipi, e filloi letrën kështu: “Pali dhe Timoteu, shërbëtorë të Jezu Krishtit, gjithë shenjtorëve në Jezu Krishtin që janë në Filipi, bashkë me peshkopët dhe dhjakët” (Filipianëve 1:1). Katër grupe janë përmendur në këtë varg. Pali dhe Timoteu ishin predikues apo ungjilltarë. Ata iu drejtuan “shenjtorëve” në Filipi, fjalë e cila u referohet anëtarëve të kishës në përgjithësi.²

Midis shenjtorëve ishin dy grupe të veçanta që Pali i quan “peshkopë” dhe “dhjakë”. Në figurën e mëposhtme tregohet se si këto katër grupe qëndrojnë në një bashkësi tërësisht të organizuar.



Peshkopët apo, si quhen ndryshe, pleqtë

Drejtuesit e bashkësisë quhen “pleq”. Ky është emërtimi më i përhapur për këtë “post”³ (Veprat 11:30; 14:23; 15:2; 20:17). Fjala greke për “plak” është *presbiter* që do të thotë “i moshuar”⁴, por përta u përket drejtuesve të kishës, theksi është te pjekuria e tyre dhe jo te mosha. Pleqtë duhet të jenë në gjendje të marrin vendime të pjekura.

Pleqtë njiheshin gjithashtu si “peshkopë” apo “kujdestarë”. Kur Pali i shkroi Titit, ai i përdori fjalët “plak” dhe “peshkop” me ndërkëmbim:

Për këtë arsye të lashë në Kretë, që ti të ndreqësh mirë çështjet që janë për t’u bërë dhe që, në çdo qytet, të caktosh pleq, ashtu siç të porosita; secili prej tyre të jetë i paqortueshëm, bashkëshort i një gruaje të vetme, të ketë fëmijë besimtarë, që të mospërfliten për jetë të shthurur dhe për pandëgjeshë. Sepse peshkopi, si administruer i shtëpisë së Perëndisë duhet të jetë i paqortueshëm, . . . (Titit 1:5–7).

Fjala e njohur “peshkop” vjen nga fjala greke *episkopos*, një fjalë e përbërë që do të thotë (siç e kemi treguar tashmë) “mbikëqyrës”. Pali u tha pleqve se Perëndia i kishte bërë ata “kujdestarë” (Veprat 20:17, 28). Pjetri i udhëzoi pleqtë të ushtronin “mbikëqyrjen” (1 Pjetër 5:1, 2). Fjala “peshkop” (“mbikëqyrës”) thekson objektin e përgjegjësisë së pleqve. Ata mbikëqyrin të gjitha problemet që i përkasin një bashkësie.⁵

Pleqtë (mbikëqyrësit) quhen gjithashtu edhe “barinj”. Kjo fjalë gjendet në formën e një emri te Efesianëve 4: “Dhe ai vetë i dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë dhe të tjerë si barinj e mësues, për përsosjen e shenjtorëve, . . .” (Efesianëve 4:11, 12). Te Veprat 20 pleqve (kujdestarëve) u është thënë “të kullostin kishën

e Perëndisë” (v. 28). Te 1 Pjetër 5 pleqve (mbikëqyrësve) u është thënë: “Ruani tufën e Perëndisë që është midis jush” (v. 2). Veprat 20 dhe 1 Pjetër 5 i përdorin të tria fjalët me ndërkëmbim.

PLEQ =
PESHKOPË (MBIKËQYRËS) =
BARINJ (KUJDESTARË)

“Bari” është përshkrimi i punës së pleqve. Ashtu si barinj të do të kujdeseshin dhe do të mbronin tufën e tyre me ndërgjegje, ashtu edhe pleqtë duhet të kujdesen dhe të mbrojnë bashkësinë lokale. Për sa i takon drejtuesve të kishës, Hebrenjve 13:17 thotë: “Dëgjoni të parët tuaj dhe nënshtroni atyre, sepse ata rrijnë zgjuar për shpirtërat tuaj, si ata që duhet të japin llogari.” Është një përgjegjësi shumë e madhe të jesh plak!

Sot, predikuesit shpesh quhen “barinj”, por në kohën e Dhjatës së Re, predikuesi nuk ishte “bariu” i kishës. Fjala “bari” i referohej pleqve, jo atyre predikuesve.⁶

Sa herë që të lexoni në Dhjatën e Re për “pleqtë” në një bashkësi, fjala është gjithmonë në shumës (Veprat 11:30; 14:23; 15:2; 16:4; 20:17; 21:18; 1 Timoteut 5:17; Titit 1:5; Jakobi 5:14; 1 Pjetër 5:1). Në asnjë rast nuk lexojmë se një plak (apo bari) i vetëm mbikëqyr bashkësinë.

Disa organizata fetare kanë “peshkopë” që kontrollojnë një zonë që përfshin shumë bashkësi. Kujtoni parimin e pavarësisë lokale. Biblikisht, një grup pleqsh mund të mbikëqyrë vetëm bashkësinë në të cilën ata janë anëtarë. Pjetri u tha pleqve: “Ruani tufën e Perëndisë që është midis jush” (1 Pjetër 5:2), jo “gjithë tufat në një zonë me rreze 200 km”.

Cilësitë e pleqve (mbikëqyrësve, barinjve) jepen te 1 Timoteut 3:1–7 dhe te Titit 1:5–9. Lexojini këto vargje. Sipas cilësive, vetëm baballarë dhe bashkëshortë kristianë e të perëndishëm mund të shërbejnë si pleq. Burrat beqarë nuk kualifikohen. Burrat pa fëmijë nuk kualifikohen. Gratë nuk kualifikohen. Burrat pa pjekuri shpirtërore dhe pa gjykim të mirë nuk kualifikohen.⁷ Çdo bashkësi duhet t’i zgjedhë vetë pleqtë e vet. Kjo është përgjegjësi e tyre. Kjo zgjedhje duhet bërë në bazë të kriterëve të gjendura në Bibël, të dhëna nga Zoti vetë.

Shërbëtorët apo dhjakët

Te letra e Filipianëve 1:1, Pali u referohet “peshkopëve” dhe “dhjakëve”. “Dhjak” do të thotë “shërbëtor”.

DHJAK = SHËRBËTOR

Dhjakët mund të mendohen si “krahu i dhjathtë i pleqve”. “Dhjakët” e parë u caktuan për t’u kujdesur për nevojat e bashkësisë në mënyrë që drejtuesit t’i kushtoheshin punës që Perëndia donte prej tyre (Veprat 6:1–6).⁸

Dhjakët nuk kanë pushtet të natyrshëm.⁹ I vetmi pushtet që ata kanë është ai që pleqtë u japin, për të zbatuar përgjegjësitë e tyre si dhjakë.

Cilësitë e dhjakëve gjenden te 1 Timoteut 3:8–13. Dhjakët duhet të zgjidhen nga bashkësia, bazuar mbi këto cilësi (shikoni Veprat 6:3, 5).

Predikuesit apo ungjilltarët

Në kishën e viteve të para, predikuesit kishin tre emërtime. Së pari, ata quheshin “predikues” (Romakëve 10:14; 1 Timoteut 2:7; 2 Timoteut 1:11) apo ata që “predikonin” (1 Korintasve 1:23). Fjala greke për fjalën “predikues” do të thotë “lajmëtar”. Ashtu si lajmëtari i mbretit do të njoftonte dekretet e tij, ashtu edhe predikuesit ishin lajmëtarë për Mbretin Jezus.¹⁰

Predikuesit janë quajtur nganjëherë edhe “shërbenjës” (Veprat 26:16; Romakëve 15:16; Efesianëve 3:7; 6:21) apo ata që kishin një “shërbesë” (Veprat 6:4; 2 Timoteut 4:5). Fjala “shërbenjës” është përkthyer nga e njëjta fjalë greke si “dhjak” dhe thjesht do të thotë “shërbëtor”. Çdo kristian është (apo duhet të jetë) një shërbëtor. Pra, çdo kristian duhet të ketë një shërbesë apo funksion të caktuar brenda bashkësisë (Efesianëve 4:12; Hebrenjve 6:10; 1 Pjetër 4:10, 11). Prandaj, predikuesi s’është i vetmi shërbëtor i bashkësisë. Kur fjala “shërbëtor” përdoret për predikuesin, është mirë që të cilësohet se “Ai është shërbëtor i Fjalës” (shiko Veprat 6:4) dhe se “Shërbesa e tij është predikimi”.

Emërtimi përfundimtar i një predikuesi në Dhjatën e Re ishte “ungjilltar” (Veprat 21:8; Efesianëve 4:11; 2 Timoteut 4:5).¹¹ Fjala “ungjilltar” vjen nga fjala greke “ungjill” dhe do të thotë “ai që predikon lajmin e mirë [për Jezusin]”.¹²

Sot, përgjegjësia e predikuesit është të predikojë dhe të mësojë Fjalën. Ai nuk ka pushtet

tjetër përtej pushtetit për të shpallur mesazhin e Perëndisë.¹³

Gjatë viteve, njerëzit kanë pasur tendencë ta lartësojnë predikuesin mbi statusin që i ka dhënë Perëndia. Tituj jobiblikë i janë vënë atij (shiko Mateut 23:9). Një prej tyre është mbiemri “i adhuruar” (reverend). Vetëm Perëndisë mund t’i drejtohem duke e quajtur “I adhuruari”. Meqënëse nuk jam Perëndia, unë nuk mund ta mbaj titullin “I adhuruari”.

Shenjtorët apo anëtarët e tjerë

Bashkësia lokale ka shumë punë dhe detyra të tjera të rëndësishme. Për shembull, janë ata që mësojnë Fjalën publikisht (shiko Efesianëve 4:11). Megjithatë, për momentin, do të përdor fjalën “shenjtorë” siç gjendet te Filipianëve 1:1 për të përfshirë të gjithë anëtarët e tjerë të bashkësisë. Çdo anëtar është nën pleqtë dhe i nënshtrohet atyre.¹⁴ Hebrenjve 13:17 thotë: “Dëgjoni të parët tuaj dhe nënshtrojeni atyre, sepse ata rrijnë zgjuar për shpirtrat tuaj, si ata që duhet të japin llogari; që ta bëjnë këtë me gëzim dhe jo me psherëtimë, sepse kjo nuk do t’ju sillte dobi.”

KONKLUZION

Ndërsa mendoheni se ku do të adhuroni dhe shërbeni, duhet të bëni pyetje si këto: “A është kjo bashkësi e pavarur apo duhet t’u përgjigjet disa krerëve apo organizatave?”; “A quhet predikuesi «bariu» i bashkësisë?”; “A mban ai ndonjë titull jobiblik të tillë si «I adhuruar»?”

Organizimi i kishës është shumë i rëndësishëm. Ai duhet të jetë në përputhje me planin e Perëndisë. ♦

¹ Do të shikojmë më vonë në këtë mësim se drejtuesit e kishës duhet të kenë disa karakteristika të dhëna nga Perëndia. Në qoftë se njerëzit në dispozicion nuk i kanë këto cilësi, nuk duhet të emërohen drejtues. Në këtë rast bashkësia ka mangësi (Titit 1:5). Bashkësia duhet të kërkojë dhe të përgatisë në mënyrë të vazhdueshme njerëz që të plotësojnë këto cilësi hyjnore.

² Rishikoni mësimin “Emërtimi i kishës së Jezusit”.

³ Fjala “post” është vendosur në thonjëza, sepse dua të theksoj se nuk është vetëm një zyrë, por një punë, përgjegjësi. Të qenët plak nuk është aq shumë post se sa është përgjegjësi.

⁴ Fjalët e përdorura për drejtuesit e kishës (të tilla si “pleq” dhe “dhjakë”) ishin pjesë e fjalorit të zakonshëm të asaj kohe. Secila nga këto fjalë është përdorur gjithashtu në një kuptim të përgjithshëm në Dhjatën e Re. Nga konteksti kuptohet nëse fjala është përdorur në kuptimin e zakonshëm apo në kuptimin e veçantë të një drejtuesi kishe.

⁵ Thuhet nganjëherë se pleqtë mbikëqyrin çështjet shpirtërore dhe dhjakët mbikëqyrin çështjet fizike. Kjo nuk është e vërtetë. Pleqtë mund të caktojnë dhjakët për t'u kujdesur për disa apo për të gjitha çështjet fizike, por megjithatë pleqtë kanë përgjegjësinë përfundimtare për çdo çështje që ndikon bashkësinë.

⁶ Në qoftë se një predikues plotëson cilësitë e një plaku dhe në qoftë se bashkësia i kërkon të shërbejë si i tillë, ai mund të bëhet njëri nga pleqtë (mbikëqyrësit, barinjët), por, biblikisht, ai nuk mund të jetë kurrë “bariu” i vetëm. Bashkësia lokale duhet gjithmonë të drejtohet në mënyrë kolegjiale nga dy ose më shumë pleq.

⁷ Te Veprat 6:3, 5 jepet shembulli i një bashkësie që i zgjedh drejtuesit mbi bazën e cilësive të përshkuara.

⁸ E vendosa fjalën “dhjak” në thonjëza, sepse nuk është e sigurt nëse këta burra ishin “zyrtarisht” dhjakë apo jo. Megjithatë, ata bënë punën e dhjakëve.

⁹ Dhjata e Re nuk na mëson se kishën duhet ta drejtojë një “këshill dhjakësh”.

¹⁰ Nuk ka rëndësi nëse një predikues punon me orar të plotë apo ka një punë tjetër dhe predikon vetëm të dielave. Ai është predikues.

¹¹ Fjala “ungjilltar” nuk ka të bëjë me atë nëse një njeri udhëton me qëllim që t'u predikojë njerëzve të ndryshëm apo qëndron në një vend për të predikuar lajmin e mirë.

¹² Forma foljore e fjalës “ungjilltar” gjendet shpesh në Dhjatën e Re. Fjalë për fjalë do të thotë “të shpallësh lajmin e mirë”, por në përgjithësi është përkthyer “predikoj” (shikoni Veprat 8:35; Romakëve 1:15).

¹³ Dhjata e Re nuk mëson asgjë për të shtuqajturin “pushtet të predikuesit”.

¹⁴ Pra, anëtarët e bashkësisë duhet t'u binden vendimeve të pleqve për aq kohë sa ata nuk e drejtojnë bashkësinë gabim (Veprat 20:28–31).

Autor: *David Roper*

Marrë nga studimi: *“Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve”*

© 2001, 2003 E VERTËTA PËR SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara